



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

02.Nr. 1978 /2019

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 79, me propozimin e drejtorisë për BPZHR, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËRVLERËSIMIN E KËRKESAVE TË NDRYSHME NË KUADËR TË DREJTORISË PËR BPZHR DHE DUKMM-së

I. Merret vendim për themelimin e komisionit profesional për vlerësimin e gjendjes faktike në teren dhe shqyrtimin e kërkesave të ndryshme që parashtrohen nga qytatarët pranë drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

II. Komisioni do të ketë përbërjen prej këtyre anëtarëve:

- Vahid Daci - Zyrtar i Kadastrit
- Driton Kaloshi- Zyrtar i të hyrave dhe
- Amir Berisha- Inspektor i Komunikacionit

III. Komisioni profesional pas parashtrimit të kërkesave në afatin e parapar ligjor do të bëjë vlerësimin e gjendjes faktike në teren dhe të nxjerrë raport me shkrim me gjendjen në teren mbi kërkesën e parashtruar, komisioni nuk do t'i shqyrtoj kërkesat që janë të dedikuara për komisionet tjera përkatëse.

IV. Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, Drejtoria për BPZHR , Drejtoria UKMM dhe Arkivi i Komunës.

Data: 06.03.2019
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rufki Suma



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.Nr. 1977/2019

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës dhe nenin 58 për përgjegjësitë e kryetarit të Komunës, Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neni 2, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M

Për heqjen e shpenzimeve për familjen e dëshmorit "Imri Curri"

I. Merret vendim për heqjen e shpenzimeve për familjen e dëshmorit "Imri Curri" nga Hani i Elezit, shpenzime të cilat janë krijuar me rastin e vdekjes së nënës së dëshmorit dhe shpenzimet i mbulon komuna pasi që familja është në gjendje të rëndë financiare.

II. Shuma e mjeteve financiare për heqjen e shpenzimeve është 536.50 € (Pesëqind e tridhjetë e gjashtë euro, e pesëdhjetë cent), sipas faturës numër 0816 e datës 19.02.2019, mjete këto që do të merren nga kategoria Dreka zyrtare - nga zyra e Kryetarit të Komunës.

III. Shpenzimet të cilat janë krijuar nga vdekja e nënës së dëshmorit, janë shpenzime të grumbulluara gjatë shujtave apo ushqimeve gjatë pritjes së njerëzve që kanë qenë për ngushllime te kjo familje..

V. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe ekzekutohet nga drejtoria për buxhet dhe financa.

VI. Me këtë vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 06.03.2019
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rufki Suma



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.Nr. 4844 /2019

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjin, Marrëveshjen e nënshkruar në mes të Komunës së Hanit të Elezit dhe Shoqatës Bëmirëse "Jetimat e Ballkanit" nr. 02/762 e datës 21.01.2019, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M

Për transferimin e mjeteve financiare

1. **LEJOHET** transferimi i mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00 €, (Pesëmijë euro) nga buxheti i komunës së Hanit të Elezit në shoqatën bëmirëse "Jetimat e Ballkanit" në llogarinë bankare me numër 11103 18280 000140, sipas nenit 6 të marrëveshjes për Bashkëpunim dhe Bashkëfinancim.
2. Komuna e Hanit të Elezit në mbështetje të kësaj marrëveshjeje do t'i transferoj mjetet financiare si në nenin 1 të këtij vendimi, në shumë prej 5,000.00 €, (Pesëmijë euro), me qëllim të përkrahjes së ndërtimit të pesë shtëpiave të familjeve skamnore në komunën e Hanit të Elezit.
3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i komunës dhe do të ekzekutohet nga drejtoria për buxhet dhe financa.
4. Me këtë vendim njoftohen: Shoqata bëmirëse "Jetimat e Ballkanit", Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 30.05.2019
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rufki Suma



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.Nr. 9993 /2019

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, nenin 58 Përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës, në bazë të Rregullorës MF - numër 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore neni, neni 4 paragrafi 6 dhe nenet 20, 21, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË JO FINANCIARE

1. Themelohet komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare në komunën e Hanit të Elezit.
2. Komisioni do të ketë këtë përberje:
 - Anvi Bushi, kryesues i komisionit
 - Fari Shkreta dhe
 - Driton Kaloshi.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni janë të përcaktuara në Rregulloren 02/2013 neni 21 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore
4. Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 08.11.2019
Hani i Elezit





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

02/ 5580 2019

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28 Qershor 2008), si dhe Rregullores (QRK) Nr.13/2017 për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, Strategjisë Shtetërore për Ri-integrimin të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019 – 2022, kryetari i komunës së Hanit të Elezit nxjerrë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues për hartimin e Planit lokal të Veprimit për Ri-integrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar.
2. Grupi Punues do të ketë këtë përbërje:

Xhemshit Kalisi	- ZKKK (Kryesues)
Sear Dernjani	- Shef i Arsimit fillor dhe të mesëm,
Naser Laçi	- Shef i DSHM-së
Kujtim Dernjani	- Udh.sektori i Shërbimeve Publike,
Amir Bushi	- Qendra për Punë Sociale,
Avni Bushi	- Zyrtar për Integritime Evropiane,
Remzi Bushi	- Zyrtar i Operatit Kadastral,
Ajete Berisha	- Udhëheqëse e Personelit dhe
Driton Halili	- Kordinator Rajonal për Ri-integrim.
3. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Grupi Punues obligohet të ndërmerr të gjitha veprimet për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Ri-integrim, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e ri-integrimit të personave të riatdhesuar në komunë.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.06.2019





Nr.02 4458 /2019

Duke u bazuar në Ligjin Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neni 13, bazuar në Rregullorën e Komunës nr.01/4805 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, kryetari i Komunës nxjerrë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve

1. Merret vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve.
2. Komisioni përbëhet prej tre anëtarëve:
 - Irfan Qajani, kryesues i komisionit
 - Fatbardha Bushi, anëtare dhe
 - Sear Dernjani, anëtar.
3. Komisioni ka për detyrë t'i shqyrtoj të gjitha kërkesat të cilat janë dorëzuar me rastin e shpalljes publike për ndarjen e subvencioneve, në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në teritorin e komunës Hani i Elezit.
4. Komisioni do t'i shqyrtoj të gjitha kërkesat brenda afatit prej 15 ditëve pas mbylljes së shpalljes publike dhe i rekomandon kryetarit të Komunës listën e përfituesve sipas nenit 8 të rregullorës për ndarjen e subvencioneve.
5. Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, DKARS-ja dhe Arkivi i Komunës.

Data: 22.05.2019
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rufki Suma



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.Nr.9522/2019

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neni 2, në bazë të Rregullorës për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve neni 21, dhe kërkesës së palës, me nr. 02 / 9522, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

1. Merret vendim për mbështetje financiare për **Haxhere Dernjani** nga komuna e Hanit të Elezit për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe për shkak se është studente në Fakultetin e Mjekësisë.
2. Shuma e mjeteve financiare për këtë mbështetje është 200 € (Dyqind euro), mjete këto që do të merren nga kategoria ekonomike subvencione - pagesë për përfitues individual.
3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe ekzekutohet nga drejtoria për buxhet dhe financa.
4. Me këtë vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 04.11.2019
Hani i Elezit





Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/11283/2019
Data: 16.12.2019

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjin mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme, nr. 03-L-139 neni 6, Vendimin e kuvendit të komunës për shpalljen me interes të përgjithëshëm të pronës me nr.665-8, nr.01/4653-2019, Aktin e vlerësimit nga zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme, nga departamenti i tatimit në pronë MEF, nr.199/1, e datës 26.07.2019 Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M
PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS nr.665-8

1. Merret vendim për shpronësimin e pronës së paluajtshme në emër të pronarit Rrahman (Xhafer) Loki, e evidentuar në zonën kadastrale Paldenicë, njësia kadastrale P-73317066 - 00665-8, vendi i quajtur KODRA SHALONI, lloji i shfrytëzimit të parcelës Livadhet, sipërfaqja e përgjithshme 90 m², me çmimin e vlerësimit 45 € për 1m² dhe me çmim të përgjithshëm 4,050.00 €.
2. Kompensimi për pronën e paluajtshme do të kryhet përmes drejtorisë për buxhet dhe financa e komunës së Hanit të Elezit, kurse pas pagesës së tërësishme të pronës obligimet kalojnë në zyrën e kadastrit të komunës, gjegjësisht Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes nga ana e ekzekutivit të komunës, ndërsa ekzekutohet pas shpalljes në Gazetën Zyrtare dhe pas rishikimit të mjeteve buxhetore të destinuar për shpronësim.
4. Me këtë vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Arkivi i Komunës.

Kryetari i Komunës
Rufki Suma

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me shumën e kompensimit të pronës ka të drejtë ankese pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit, brenda 30 ditëve kalendarike, pas hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar.